



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM

MARRJE ME QIRA TË PASURISË SË TË TRETËVE PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË AKEP

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në kuadër të përmbushjes së funksioneve të tij ligjore dhe organizative, vlerëson të nevojshme sigurimin me qira të ambjenteve të përshtatshme për zyra, me qëllim krijimin e kushteve optimale për akomodimin e një pjese të stafit (40 punonjës) dhe ushtrimin e funksioneve institucionale në mënyrë të pandërprerë dhe efikase.

Kjo nevojë rrjedh nga kërkesa për hapësira pune që plotësojnë standardet e domosdoshme funksionale, teknike dhe infrastrukturore, duke garantuar aksesueshmëri, siguri dhe pajisje të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë administrative dhe operacionale të institucionit, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

I. KËRKESAT DHE SPECIFIKIMET KRYESORE PËR AMBIENTET

- Ambjent për zyra me sipërfaqe totale të shfrytëzueshme afërsisht 600 m² të përshtatshme për akomodimin maksimalisht të 40 punonjësve; përfshirë sallë mbledhje, recepsion dhe 6 tualete.
- Ambjenti duhet të jetë pjesë e një godine të dedikuar për zyra/njësi shërbimi, preferohet të jetë pozicionuar në të njëjtin kat, ose të pozicionuara afër njëra tjetrës në mënyrë që të sigurohet komunikim/akses/ndërveprim, të sigurojë përmbushjen e kërkesave minimale sipas kuadrit ligjor për hapësirat në vendin e punës. Të ketë ndriçim natyral të nevojshëm;
- Ambjentet e reja ku do të akomodohet stafi i AKEP të jenë jo më larg se 400 m nga selia e AKEP, rruga “Reshit Çollaku” Nr. 43, për të mundësuar lehtësisht dhe me efikasitet bashkëpunimin/koordinimin e mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative mes organeve drejtuese dhe administratës së pozicionuar në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave.
- Ambjentet e reja të jenë pozicionuar në rrugë kryesore dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme nga institucionet e tjera shtetërore me të cilat AKEP ka bashkëpunim të vazhdueshëm.
- Preferohet që ambjenti të jetë në kate të ulëta. Në rast se ambjentet janë në kate të larta të godinës, të sigurohet ashensor.
- Godina në të cilën do të transferohet AKEP duhet të plotësojë kushtet për zhvillim normal të punës pa patur nevojë për kryerjen e investimeve shtesë.
- Ambjentet ku do të akomodohet stafi i AKEP të ketë vend parkimi për automjetet zyrtare, minimalisht për 3 (tre) automjete.

- Instalimet elektrike të jenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për postet e punës, si dhe instalimet informatike të brendshme.
- Ambjentet duhet të kenë rrjet intraneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune.
- Ambjentet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.
- Ambjentet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7. Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së Qirasë do të përmbushen nga AKEP.
- Të ketë sistem sigurie, alarm dhe mbrojtje kundër zjarrit dhe të ketë dalje emergjence.
- Ambjenti duhet të jetë i aksesueshëm dhe i përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuara PAK sipas legjislacionit në fuqi.
- Të sigurohet vend në hyrjen kryesore për vendosjen e tabelës identifikuese të institucionit shtetëror.
- Ambjentet duhet të jenë bosh dhe të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 60 ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.

II. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR KUALIFIKIM

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Dokumentacionin që vërteton se ofertuesi e zotëron pronën në mënyrë ligjore.
2. Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro lëshuar nga ASHK-ja.
3. Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
4. Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.
5. Vërtetim që ofertuesi që nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
6. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - 6.1 NIPT/NUIS, çertifikata e regjistrimit dhe Ekstrakt Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - 6.2 Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - 6.3 Vërtetim që nuk ka sigurime shoqerore të pashlyera nga e-Sigurime.
7. Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me AKEP;
8. Vetëdeklarim mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

Dokumentacioni që lëshohet nga institucione shtetërore duhet të jetë original ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

III. DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT DHE OFERTËS EKONOMIKE

1. Dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jetë i futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit. Mbi zarf duhet të jetë shënuar: **“Ofertë për marrje me qira ambiente zyrash për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”**.
2. Oferta e qiradhënësit që specifikon sipërfaqen dhe çmimin mujor (në LEKE) të qerasë për m2 sipërfaqe, për një periudhë jo më pak se **3 (tre) vite** sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emri dhe NIPT-11 subjektit	Përshkrimi	Siperfaqja totale në m2	Cmimi për m2 / muaj (në Lekë)	Sasi kohëzgjatja	Vlera totale (në Lekë)

3. Dorëzimi i dokumentave dhe ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës **11/08/2025**, ora **16:00**, me postë ose dorazi pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)", me adresë: Rr. "Reshit Çollaku" Tiranë.
4. Ofertuesi duhet të pranojë që pagesa e qirasë të bëhet çdo muaj në lekë, bazuar në çmimin e ofruar dhe sanksionuar në kontratën e qirasë, kundrejt lëshimit të faturës tatimore.

IV. KRITERE VLERËSUESE

Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët (oferta ekonomikisht më e favorshme) e cila plotëson të gjitha kriteret teknike, ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për punonjësit e AKEP.

DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KËRKESAVE TEKNIKE

(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Objekti: "Marrje me qira të pasurisë së të tretëve për ushtrimin e aktivitetit të AKEP"

Data e zhvillimit të procedurës: _____ 2025, ora ____:00

Unë, i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të Ofertuesit _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Përbushim të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe këtë e vërtetojmë me certifikata dhe dokumente të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.
2. Objekti që ofrojmë me qira respekton të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, dhe kërkesat e AKEP-t, përfshirë:
 - Përshtatjen e vendit të punës në të gjitha pjesët përbërëse me natyrën e aktivitetit që do të zhvillohet në të;
 - Kushtet minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;
 - Qëndrueshmërinë dhe pastërtinë e objektit (muret, dyshemetë dhe tavanet duhet të jenë të forta dhe në gjendje të mirë);
 - Marrjen e të gjitha masave të domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit të punës nga ndotja e ajrit, lëndët kimike, radioaktiviteti, zhurmat dhe dridhjet, si dhe çdo element të ngjashëm që mund të jetë i dëmshëm për jetën dhe shëndetin e punonjësve.

Data e dorëzimit të deklaratës: _____ 2025

Nënshkrimi i ofertuesit: _____

Emri i plotë i përfaqësuesit të autorizuar: _____

Pozicioni: _____

Vula e subjektit ofertues

OFERTË EKONOMIKE
(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Emri i Ofertuesit: _____

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Prokurimi: Marrje ambienti me qira / _____ 2025

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Marrja me qira e pasurisë së të tretëve për ushtrimin e aktivitetit të AKEP”**

Në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të prokurimit për procedurën në fjalë, unë, Ofertuesi _____, deklaroj sa më poshtë:

1. Çmimi total i ofertës sonë është: _____ [monedha dhe vlera në lekë]

Nr.	Emri dhe NIPT-11 subjektit	Përshkrimi	Sipërfaqja totale në m2	Cmimi për m2 / muaj (në Lekë)	Sasi kohëzgjatja	Vlera totale pa TVSH (në Lekë)
Çmimi Neto)						
Çmimi Total						

Kohëzgjatja e kontratës: _____

Afati i ofrimit të shërbimit: _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi dhe vula e ofertuesit: _____

Emri i përfaqësuesit të autorizuar: _____

Pozicioni: _____

**DEKLARATË PËR MOSKEKZISTENCËN
E KONFLIKTIT TË INTERESIT**
(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Objekti i prokurimit: **“Marrje me qira të pasurisë së të tretëve për ushtrimin e aktivitetit të AKEP”**

Data e zhvillimit të procedurës: _____ 2025, ora ____:00

Unë, _____ i _____ nënshkruari _____,
me funksionin _____, përfaqësues ligjor i Ofertuesit
_____, që merr pjesë në procedurën e
sipërpërmendur,

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se:

- Nuk ndodhemi në kushtet e konfliktit të interesit as unë personalisht dhe as persona të tjerë me të cilët kam lidhje gjaku ose shoqërore nuk kemi ndonjë lidhje pune, kontraktuale apo përfitimi të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me personat që përfaqësojnë ose marrin pjesë në emër të AKEP në këtë procedure qiraje;
- Nuk kemi ndikuar dhe nuk do të përpiqemi të ndikojmë në mënyrë të padrejtë mbi vendimmarrjen e institucionit;
- Në rast se gjatë zhvillimit të procedurës do të konstatohet ndonjë situatë që bie ndesh me këtë deklaratë, angazhohem të njoftoj menjëherë AKEP-in dhe të marr masat e nevojshme për përjashtimin nga procedura, sipas parashikimeve ligjore.

Data: _____ 2025

Emri i përfaqësuesit të autorizuar: _____

Pozicioni: _____

Nënshkrimi: _____

Vula e ofertuesit